



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 531. date 31.10.2002

PER

**SHPALLJEN E KOMPLEKSIT LIGATINOR TE BUTRINTIT DHE TE TERRITORIT  
PERRETH TIJ ZONE NATYRORE VEÇANERISHT E MBROJTUR DHE  
PERFSHIRJEN E TIJ NE LISTEN E LIGATINAVE ME RENDESI  
NDERKOMBETARE, VEÇANERISHT SI HABITATE TE SHPENDEVE UJORE**

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës dhe te neneve 2 e 4 te Konventës "*Për ligatinat me rendësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate te shpendëve ujore*", me propozimin e Ministrit te Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Territori natyror i kompleksit ligatinor te Butrintit (Liqeni i Butrintit, Parku Kombëtar i Butrintit, Kepi i Stillos, ishujt e Ksamilit) shpallet zone natyrore, veçanërisht e mbrojtur, për t'u përfshirë ne listën e Konventës "*Për ligatinat me rendësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate te shpendëve ujore*".

2. Kufijtë e kësaj zone janë:

ne veri -Kanali i Cukes. rruga automobilistike qe lidh fshatin Cuke me Dritasin dhe Pllaken;

ne lindje -vija lidhëse Pllake-Murrsi, qe kalon ne malin e Miles;

ne jug -Murrsi -kufiri jugor me Greqinë;

ne perëndim -nga derdhja e Bistrices (kanali i Cukes) deri ne kufirin shtetëror me Greqinë, përfshirë ishujt e Ksamilit dhe te Stillos, duke u futur 1 km ne thellësi te detit Jon

3. Kjo zone përfshin një sipërfaqe prej 13 500 ha, sipas hartës qe i bashkëlidhet këtij vendimi, ku pjesa qendrore është liqeni i Butrintit (1600 ha).

4. Zona, për te siguruar mbrojtje dhe zhvillim te qëndrueshëm, ndahet ne pese kategori:

-ato te shënuara me "A" përcaktohen si zona qendrore te ruajtjes se biodiversitetit dhe mbrohen ne mënyre strikte (418 ha);

-ato te shënuara me "B" përmbledhin tere territorin e Parkut Kombëtar te Butrintit (PKB) dhe përcaktohen si zona arkeologjike te trashëgimisë kulturore (408 ha);

-ato te shënuara me "C" përcaktohen si zona te burimeve natyrore, ku kryhen veprimtari tradicionale ekonomike dhe re menaxhimit te qëndrueshëm te burimeve natyrore, (3060) ha;

-ato shënuara me "D" përcaktohen si zona buferike, pa vendbanime, ku zhvillohen veprimtari tradicionale ekonomike (8 962 ha);

-ato te shënuara me "E" përcaktohen si zona buferike, qe përmbledhin vendbanimet urbane, ku zhvillohen veprimtari tradicionale ekonomike (652 ha)

Veprimtaritë ekonomike ne territorin e ligatinave lejohen kur janë tradicionale, ruajnë vlerat mjedisore dhe zhvillohen ne përputhje me objektivat e planit te menaxhimit te zonës

**5.** Ngarkohet Ministria e Mjedisit, qe, ne bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë e te Ushqimit, Ministrinë e Kulturës. Rinise e Sporteve, me organet e pushtetit vendor dhe me organizatat jofitimprurëse, te hartoje planin e menaxhimit te zonës.

**6.** Ngarkohet Zyra e Administrimit dhe e Koordinimit e qytetit antik te Butrintit, Sarande, nen juridiksionin e Ministrisë se Kulturës. Rinise dhe Sporteve, qe, ne bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme te pyjeve dhe te Kullotave dhe Drejtorinë e Peshkimit. te realizoje menaxhimin e zonës dhe te kontrolloje zbatimin e planit menaxhues, ne përputhje me ligjin nr.8906. date 6.6.2002 "*Për zonat e mbrojtura*".

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Fatos Nano**